

RELACION
PËR
AKTIN NORMATIV
“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.115/2021
“PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

A. MËNYRA E NDËRHJRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë¹:

1. *Nevoja dhe urgjenca* si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. *Përkohshmëria* e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. *Fuqia ligjore* e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ *me fuqinë e ligjit* nga Kuvendi.

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:

Neni 101 ka parashikuar ‘**nevojën**’ dhe ‘**urgjencën**’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas vlerësimit të ecurisë 10 dhe 11 mujore të treguesve fiskalë, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të tretë të buxhetit 2022, me fokus primar garantimin e finalizimit në terma optimal të vitit buxhetor 2022 sa i takon performancës së shpenzimeve, të ardhurave dhe qëndrueshmërisë së parametrave makroekonomikë në tërësi.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTLIGJI

Ky rishikim i buxhetit 2022, i cili propozohet t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, ka si synim kryesor:

- ✓ *Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 5 miliardë lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të realizimit të zërave të tyre për 10 mujorin 2022.*
- ✓ *Axhustimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre për pjesën e mbetur të vitit 2022, me një rritje NETO po në masën 5 miliardë lekë.*
- ✓ *Rruajtjen të pandryshuar te deficieti buxhetor dhe borxhit publik.*

C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTLIGJI

Mbështetur në vlerësimin e ecurisë së deritanishme të treguesve makro-fiskalë dhe buxhetorë, paraqesim në vijim propozimet konkrete në kuadër të rishikimit të dytë të ligjit të buxhetit 2022, i cili referuar zërave më të rëndësishëm reflekton këto elementë kryesorë:

NË ASPEKTIN MAKRO:

Në këndvështrimin e parametrave makroekonomikë, ky akt normativ parashikon:

- ✓ **Sa i takon Borxhit Publik**, ai mbetet i pandryshuar. Nderkohe kostoja e shërbimit të borxhit është rishikuar në ulje. Shpenzimet e parashikuara për interesa gjatë vitit 2022 vlerësohet të ketë një kursim në vlerën prej 3 miliard lekë në interesat e brendshme si dhe 2.96 miliard lekë në interesat e huaja.
 - *Gjatë vitit 2022 pati rritje të konsiderueshme të normave, sikundër ishte parashikuar, por nga ana tjetër ka patur një ngadalesi të huamarrjes së pritshme si nga burimet e brendshme edhe nga burimet e huaja, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shpenzimet e interesave për vitin përkatës.*
 - *Gjithashtu në këtë kategori shpenzimi parashikohen edhe fonde që mund të nevojiten të paguhen nga buxheti i shtetit për kredi të garantuara nga qeveria, në rast se huamarrësi dështon të paguajë interesat e kredive të garantuara. Gjatë vitit 2021 u emetuan një sërë garancish në përfitim të sektorit energjetik, ku referuar kushteve të vështira me të cilat ky sektor po përballlet së fundmi, u vlerësua i lartë risku i pagesës së detyrimeve që rrjedhin nga këto kredi të garantuara nga buxheti i shtetit. Ndërkohë, gjatë vitit 2022 interesat e këtyre kredive të garantuara, janë paguar nga vetë operatori i energjisë, duke sjellë gjithashtu një kursim në fondin e parashikuar për këtë qëllim.*
- ✓ **Sa i takon deficietit buxhetor**, ai mbetet i pa ndryshuar në nivelin 83 863 milion lekë.

NË KAHUN E TË ARDHURAVE:

Ky akt normativ parashikon një rritje të planit të të ardhurave të përgjithshme me plus 5 miliardë lekë krahasuar me planin e rishikuar sipas AN nr.12/2022, e cila përfshin:

- *Rritjen me +5 miliardë lekë të të ardhurave tatimore;*
- *Rritjen me +2 miliardë lekë të të ardhurave Jotatimore, në zërin 'Kthim kapitali nga AIC', që ka të bëjë me një sistemim veprimi nga pikëpamja kontabël në Llogarinë e Thesarit;*
- *Reduktimin me -2 miliardë lekë të të ardhurave nga Grantet e Huaja.*

Sa i takon rritjen në masën +5 miliardë lekë të të ardhurave Tatimore, ajo mbështetet në:

- *Ecurinë positive të të ardhurave për 10 mujorin 2022*
- *Vleresimet e pritshme deri në mbylljen e vitit 2022.*
- *Ndikimin në tatime ad-valorem të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.*

Të ardhurat tatimore dhe doganore për 10 mujorin e vitit 2022 u realizuan në masën 4.9 miliardë lekë ose 1.2% më shumë se plani 10 mujor 2022, si dhe 62.7 miliardë lekë ose 17.4% më shumë krahasuar me 10 mujorin 2021. Pas analizës dhe vlerësimeve të MFE lidhur me ecurinë e deritanishme të të ardhurave buxhetore, si edhe pritshmërinë e performancës së tyre deri në fund të vitit 2022, kjo rritje propozohet të bëhet në ato zëra që kanë shënuar një realizim apo tejkalim të planit të tyre fillestar, përgjatë 10 muajve të vitit dhe konkretisht:

- *Tatimi mbi Vlerën e Shtuar +3 miliardë lekë*
- *Kontributet (fondet speciale) +2 milionë lekë.*

NË KAHUN E SHPENZIMEVE:

Nisur nga sa mësipër parashtruar, propozimet sa i takon rishikimit të zërave të shpenzimeve buxhetore, konsistojnë në:

1. Rritjen me rreth +30.2 miliardë lekë te shpenzimeve të përgjithshme, të cilat arrijne nivelin 665.7 miliardë lekë. Kjo vlerë është përftuar përmes kombinimit të shkurtimeve në zërat që kanë shënuar mosrealizim në nivel 11 mujor, dhe alokimit të shtesave për politikën dhe projektet me performancë optimale. Konkretisht, propozimet tona konsistojnë në:

- ✓ **+12.4 miliardë lekë** për Fondin e Rindërtimit, me qëllim plotësimin e nevojave për financimin e projekteve në vazhdim.
- ✓ **+5 miliardë lekë** për projektet në vazhdim në Infrastrukturë në programin “Transporti rrugor” për avancimin e projekteve strategjike si Tuneli i Llogarasë dhe Unaza e Tiranës dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
- ✓ **+2 miliardë lekë** për projektet në vazhdim për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmirësimin e furnizimit me ujë të popullsisë dhe mbulimin e detyrimeve të prapambetura.

- ✓ **+2 miliardë lekë** për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC), në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit.
- ✓ **+2 miliardë lekë** për Aviacionin Civil dhe **+1.2 miliardë lekë** për Albgaz, bazuar në kërkesat zyrtare të MIE, përkatësisht:
 - *Sa i takon Aviacionit Civil, në kuadër të zbatimit të Master Planit, hartimit të politikave zhvilluese të transportit ajror, përmirësimit të kuadrit ligjor, teknik dhe administrativ, MIE në përputhje me standartet ndërkombëtare synon zhvillimin, implementimin e investimeve të nisura në infrastrukturën aeroportuale. Për përmbushjen e këtyre prioriteteve, për zhvillimin e infrastrukturës ajrore, si fushë e veprimtarisë së MIE, nevojitet mbështetje financiare shtesë.*
 - *Albgaz sh.a përballet me nevoja emergjente në përgjigje të dinamikave të fundit në kuadër të sigurisë energjetike, diversifikimit të burimeve dhe politikave të dekarbonizimit, duke pranuar rolin thelbësor të gazit natyror si një “transition fuel” të domosdoshëm për ekonominë në mbarë botën. Qeveria e Shqipërisë është e vendosur për të mbështetur gazifikimin e vendit, pasi është faktor kryesor dhe krijon një moment të rëndësishëm për zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri. Në këtë kuadër janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani prestigjioze ndërkombëtare për partneritet dhe për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit dhe realizimin e projekteve. Rrjedhimisht, për realizimin e këtyre nismave kërkohet mobilizim i vlerave monetare të cilat Albgaz nuk mund t’i disponojë nga të ardhurat e aktivitetit të saj modest dhe në kushtet tejet të vështira të një rrjeti transmetimi jashtëfunksioni dhe në mungesë të një tregu të brendshëm.*
- ✓ **+1 miliardë lekë** për nevoja operative të Policisë së Shtetit, uniforma, karburant etj.
- ✓ **+800 milionë lekë** për MIE në zërin ‘Mirëmbajtje rrugore’, me qëllim shlyerjen e detyrimeve të akumuluar.
- ✓ **+674 milionë lekë** për projektet në vazhdim me financim të huaj “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë dhe emergjenca Covid me BB”, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- ✓ **+500 milionë lekë** për projektet në vazhdim për projektet e dixhitalizimit dhe qeverisjes elektronike për Policinë e Shtetit dhe DPT.
- ✓ **+200 milionë lekë** si financim shtesë për Skemën Kombëtare të Fermerëve.
- ✓ **+250 milionë lekë** për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), për financimin e infrastrukturës sportive në vend.
- ✓ **+70 milionë lekë** për FSHF, për mbështetjen e Ekipit Kombëtar të Futbollit.
- ✓ **+150 milionë lekë** për Fondin rezervë të buxhetit të shtetit 2022.
- ✓ *Etj.*

2. Rreth -25.2 miliardë lekë shkurtime të shpenzimeve korente e kapitale, referuar zërave që kanë shënuar mosrealizim në nivel 11 mujor, ku ndër më kryesoret përmendim:

- ✓ **Rreth -9.8mld lekë** të shpenzimeve kapitale me Financim të Huaj (*7.7mld lekë kredi dhe 2mld lekë grante*), si rrjedhje e ecurisë së ngadaltë në zbatim, problematikave me shpronësimet, etj.
- ✓ **Rreth -5.9mld lekë** shkurtime në planin e shpenzimeve për interesa, bazuar në realizueshmërinë e ulët të huamarrjes së pritshme nga burimet e brendshme dhe të huaja.
- ✓ **Rreth -5.3mld lekë** shkurtime të shpenzimeve kapitale me Financim të Brendshëm, si rrjedhje e ecurisë së ngadaltë në nivel 11 mujor, problematikave me procedurat e prokurimeve, efekteve negative të rritjes së cmimeve të inpueteve të ndërtimit, etj.
- ✓ **Rreth -1.88mld lekë** kursime nga Paketa e Rezistencës Sociale, bazuar në përdorimet faktike të fondeve të planifikuara për këtë qëllim.
- ✓ **Rreth -1mld lekë** shkurtim të shpenzimeve të Fondit të Kompesimit të Pronarëve, si rrjedhje e performancës së ulët gjatë vitit 2022.
- ✓ *Etj.*

Sa i takon Shpenzimeve Vendore, ndryshimet konsistojnë në:

- ✓ Shtesën në masën **1 miliard lekë** për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Kjo shumë është shpërndarë sipas njërive të vetëqeverisjes vendore duke marrë si kriter peshën e detyrimeve të secilës njësi ndaj totalit të detyrimit të muajit dhjetor 2021, si dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2018-2021. Ky fond do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke i dhënë përparësi detyrimit më të vjetër të pa paguar. Bashkia Tiranë nuk përfshihet në shpërndarjen e transfertes specifike për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për arsye se ka kapacitet të lartë në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.
- ✓ Shtesën në masën **165 milion lekë** për transfertën specifike për sportin përkatësisht për rikonstrukcionin e pallatit të sportit në Gjirokastër 100 milionë lekë dhe rikonstrukcionin e pallatit të sportit në Përmet 65 milionë lekë.
- ✓ Shtesën në masën **70 milionë lekë** për pjesën e taksave të ndara që i transferohen buxhetit vendor, për shkak të realizimit të lartë të tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksës së rentës minerare në rang vendi. Kjo do të sjellë më shumë financim për buxhetin vendor, për të mundësuar ofrimin e më shumë shërbimeve publike për qytetarët.

- ✓ Shpërndarjen nga fondi rezervë i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme në masën **70 milionë lekë** për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e shpenzimeve të veprimtarive dhe të funksioneve për ato njësi të vetëqeverisjes vendore që nuk kanë realizuar mjaftueshëm nivelin e të ardhurave, për të mos cënuar ofrimin e shërbimeve publike të domosdoshme.
- ✓ Pakësimin në masën **65 milionë lekë** të financimit të huaj vendor për shkak të mos realizimit të plotë deri në këtë periudhë.

Në përfundim, vlen të theksojmë se, ndryshimet e propozuara nuk prekin deficitin buxhetor i cili nuk ka pësuar ndryshime. Kjo, nisur nga ecuria pozitive e të ardhurave buxhetore për 10 mujorin 2022 dhe pritshmëria gjithashtu pozitive e realizimit të tyre në nivel vjetor, që ka sjellë edhe mbulimin e plotë të të gjitha nevojave për financim në kahun e shpenzimeve, të akomoduar përmes këtij akti normativ, si edhe do të shërbejnë për sigurimin deri në fund të vitit 2022 të qëndrueshmërisë së parametrave kyç makro-fiskalë.

PROPOZUESI

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ